



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 25 / 10 / 2023

VENDIM

Nr. 39 datë 25 / 10 / 2023

PËR

SISTEMET E ALARMIT NË DIGAT E MËDHA ME RRIK TE LARTE DHE RRJETIN E TRANSMETIMIT NE QENDRAT URBANE POSHTE TYRE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 25.10.2023 mori në shqyrtim problematiken në lidhje me instalimin dhe funksionimin e sistemeve të alarmit në digat e mëdha me rrisht të lartë si dhe rrjetin e transmetimit në zonat urbane poshtë tyre.

Në baze të informacionit të ardhur gjatë vitit 2023 sipas kërkesës së KKDM nga shfrytëzuesit e digave, rezultojnë se **50 diga të mëdha janë me rrisht të lartë në lidhje me dëmet dhe humbjet e njerëzve në zonat poshtë tyre**. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm si dhe duke patur parasysh kërkesat e legjisllacionit në fuqi, rastet e fundit të fatqësive të ndodhura për shkak të prishjeve të digave në Norvegji, Libi, Turqi dhe Nigeri, problematikat e konstatuara në lidhje me mungesën e sistemeve të alarmit dhe rrjeteve të tyre të transmetimit në digat e mëdha të vendit tonë, ardhjen e periudhës së rreshjeve si dhe domosdoshmërinë e instalimit të këtyre sistemeve në diga dhe rrjeteve të tyre të transmetimit në zonat urbane poshtë tyre, KKDM

VENDOSI

1- Tu kërkoj të gjithë shfrytëzuesve të digave të mëdha me rrisht të lartë sipas tabelës bashkëlidhur këtij Vendimi, të marrin masat e duhura emergjente për furnizimin dhe instalimin e sistemeve të alarmit në diga dhe rrjetet e tyre të transmetimit në zonat urbane poshtë tyre duke u bazuar në nenin 28 dhe 35 të VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e digave dhe dambave", Udhëzimin Nr. 248, datë 28.01.2000 të gjashtë Ministrive në lidhje me planet e alarmit si dhe hartat e përmbytyjeve në rastet e prurjeve maksimale apo prishjes së mundshme të digës;

2- Tu kërkoj të gjithë shfrytëzuesve të digave të mëdha me rrisht të lartë sipas tabelës bashkëlidhur të dërgojnë informacionin e duhur në KKDM dhe AKMC në lidhje me funksionimin, skemat dhe testimet e sistemeve të alarmit në diga për ata që i kanë instaluar dhe planin e punës për procesin e FV të sistemeve të alarmit në diga dhe rrjeteve të transmetimit në zonat urbane poshtë tyre për shfrytëzuesit e digave të mëdha që nuk i kanë instaluar deri me sot. Ky informacion duhet të dërgohet pranë KKDM brenda muajit nëntor 2023;

3- KKDM në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të përgatitin Udhëzuesin përkatës në lidhje me kërkesat kryesore të sistemeve të alarmit në diga dhe rrjetit të transmetimit në zonat urbane poshtë digave;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

4- KKDM t'ju kërkoj të gjithë shfrytëzuesve të digave të mëdha me rrisht të lartë për humbjen e jetëve të njerëzve në zonat urbane poshtë tyre sipas tabelës bashkëlidhur **të përgatitën dhe të përditësojnë hartat e përmbytjeve dhe Planet e Gadishmërisë për rastet e emergjencave civile** për shkak të prurjeve maksimale apo prishjes së mundshme të ndonjë dige duke marrë për bazë sigurinë për prurjet e dhëna në Vendimin e KKDM, Nr. 36, datë 25.10.2023 si dhe numrin e njerëzve në rrezik që ndodhen në zonat urbane poshtë digës sipas regjistrimit të fundit të popullsisë.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kerkuara në kete vendim sipas legjisllacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

